



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:178334

Datë: 19.07.2024

Numri i dokumentit: 05960815

KE.nr.156/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit “Aldi Construction” L.L.C., NUI: 810812075, me seli në rr. “Robert Doll”, nr. 54, në Prishtinë, përfaqësuar nga pronari A.D. dhe Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, SH.P.K., kundër të paditurit “ENK Invest Group” SH.A. – “Prishtina City Center” SH.A., NUI: 810519019, me seli në rr. “Robert Doll”, nr.5, në Prishtinë, i përfaqësuar nga avokati Atdhe Dika, me objekt kontesti kompensim dëmi, vlera e kontestit 2,343,456.13 €, jashtë seancës, me datën 19.07.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJES DORË NGA KËRKESËPADIA

- I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Aldi Construction” L.L.C., me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura “Prishtina City Center” SH.A., që paditësit të ia kompensoj dëmin në shumën e përgjithshme prej 2,343,456.13 € dhe atë në emër të dëmit material shumën prej 1,299.318.36 €, si dhe në emër të fitimit të humbur shumën prej 1,044.137.65 €, të gjitha me kamatëvonesë prej 8 % në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë 29.06.2018 e deri në përmbushjen definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

A r s y e t i m

Paditësi “Aldi Construction” L.L.C., me seli në Prishtinë, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Ekonomike, më datën 29.06.2018 ka paraqitur padi, ndaj të paditurit “ENK Invest Group” SH.A., – “Prishtina City Center” SH.A., me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim dëmi.

Kjo çështje juridike në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike është evidentuar sipas numrit EK.nr.370/2018, ndërsa pas themelimit të Gjykatës Komerciale, e njëjta është transferuar për shqyrtim në këtë gjykate dhe ka marr numrin e ri KE.nr 158/22.

Paditësi përmes drejtorit ekzekutiv A.D., përmes parashtresës së datës 21.06.2024, ka deklaruar se heq dorë nga gjykimi lidhur me padinë e paraqitur, duke kërkuar nga ana e gjykatës që të pushohet gjykimi lidhur me këtë çështje kontestimore, konform nenit 149 të LPK-së.

Sipas nenit 149 par. 1 të LPK-së, përcaktohet se “ *Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë), ndërsa me par. 2 të këtij neni përcaktohet se “ Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur”.*

Andaj Gjykata duke vepruar sipas parashtresës së paditësit dhe meqenëse në rastin konkret bëhet fjalë për kërkesa me të cilat palët mund të disponojnë lirisht, në kuptim të nenit 149 lidhur me nenin 450 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 156/22, datë 19.07.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.